

GJYKATA E QARKUT TE PRIZRENIT, ne kolegj te perber nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Kanev si kryetari i trupit gjykues, gjyqtari te EULEX-it Witold Jakimko dhe gjyqtari-vendor Enxhel Ceta-si anetar-te-kolegjit,-ne-rastin-e-pembarimit-te [REDACTED] nga Prizreni, i perfaqesuar nga [REDACTED] nga Prizreni kunder debitorit [REDACTED] nga Prizreni i perfaqesuar nga avokati [REDACTED] nga Prizreni, ne lidhje me ekzekutimin e aktvendimit per masat e perkohshme, duke vendosur ne baze te ankeses se perfaqesuesit te kreditorit te parashtruar 18.12.2008, kunder aktvendimit te gjykatës komunale te Prizrenit E. No. 569/2005 te datës 11.12.2008. Ne seancën e mbajtur me 18.06.2010 ka lëshuar si ne vijim:

AKTVENDIMIN

Aktvendimi i gjykatës komunale te Prizrenit ne rastin e pembarimit E. No. 569/2005 te datës 11.12.2008 nëpërmjet kësaj është **revokuar** dhe rasti **dërgohet** ne instancën e pare te gjyqtari i ekzekutimit për procedure te me tujeshme.

ARSYETIM

Ankesa e lejueshme; aktvendimi i ankimuar i gjykatës komunale te Prizrenit E. No. 569/2005 te datës 11.12.2008 e ka pezulluar procedurën e ekzekutimit te masave te perkohshme te lëshuar nga gjykata komunale e Prizrenit me aktvendim C. nr. 420/05 te datës 24.05.2005 kunder debitorit [REDACTED] nga Prizreni.

Përfaqësuesi i kreditorit ne afate kohor ka parashtruar ankesën kunder aktvendimit te ankimuar ne baze te shkeljeve procedurale, vërtetim te gabuar dhe gjendjes faktike dhe shkelje te ligjit penal. Përfaqësuesit kërkuan shfuqizim te aktvendimit ne fjale dhe dërgimin e rasis për procedim te me tujeshme. Ankesa është konsideruar si e parashtruar me kohe dhe ankesesi kishite te drejte ligjore ne parashtrim.

Histori procedurale; me 19.05.2005 [REDACTED] ka parashtruar kërkesë padinë kunder te paditurit [REDACTED] për pengim te posedimit me parashtrese për masat e perkohshme për ndalimin e ndërtimit ne parcelë te kontestueshme te regjistruar si nr. [REDACTED] ne [REDACTED] ne Prizren. Rasti e mori numrin e gjykatës C. nr. 420/05. Me 24.05.2005 Gjykata komunale e Prizrenit ka lëshuar aktvendimin duke i urdhëruar [REDACTED] qe menjëherë te ndërpres te gjitha punimeve ndërtimore ne ngastrën e cekur. Me 01.08.2005 paditësi ka parashtruar parashtrësën për ekzekutim te masave te perkohshme ne baze te nenit 444 te LPK (te vjetër). Ekzekutimi n fjale kur nuk është kryer ashtu qe te drejta e paditësit janë trezikuar dukshëm.

Ne ndërkohë mbas mos aktivitetit tre vjeçar gjykata komunale e Prizrenit lëshon aktvendimin e ri ne rastin 420/05. Me 12.09.2008 gjykata e refuzon padinë treth pengimin posedimit si te pa bazuar dhe i anuloi masat e perkohshme te cilat janë lëshuar me ane te aktvendimit C. nr. 420/05 te datës 24.05.2005.

Gjykata e ka arsyetuar këtë aktvendim duke u referuar vendimit të plotfuqishëm në rastin C. nr. 805/07 të datës 19.02.2008 e cila e ka konfirmuar procesin e të paditurit [REDACTED] rreth ngastrës në fjalë.

Konform vendimit të plotfuqishëm dhe duke vepruar në bazë të parashtrës së debitorit gjyqtar i gjykatës komunale për ekzekutim e ka pezulluar procedurën për masat e përkohshme mbasi nuk kishte masa për ekzekutim.

Vendimi në rastin 420/05 në kohë është ankimuar nga [REDACTED] dhe ankesa e tij është aprovuar nga gjykata komunale e Prizrenit me aktvendim të datës 17.05.2010 në rastin e gjykatës së Qarkut Ac. nr. 595/08. Instanca e dytë plotësisht e revokoi aktvendimin i cili refuzoi padinë rreth pengim posedimit dhe e ka anuluar urdhrin e përkohshëm për të ndaluar zhvillimet në ngastër.

Vlerësimi ligjor: gabimet të vazhdueshme dhe lenie pas dore kanë parandaluar në mënyrë efektive ankuesin për realizimin e masave të përkohshme të garantuara dhe kjo e ka zgjatur procedurën jashtë kohës së arsyeshme. Masat e përkohshme nuk janë ekzekutuar, rasti i ekzekutimit është lënë në pritje për shumë vite. Me pas pezullimi i procedurës së ekzekutimit i cili ka ndodhur më 11.12.2008 është vetvetiu i diskutueshëm. Është arsyetuar me fakt se s masat e përkohshme janë anuluar më 12.09.2008, mirëpo aktvendimi i cili është anuluar nuk ishte i plotfuqishëm dhe në mënyrë të suksesshme është bere ankimimi kundër tij. Si parim i përgjithshëm masat e përkohshme të garantuara në bazë të dispozitave për padi civile duhet të jenë të efektshme dhe mund të ekzekutohen në bazë të padisë dhe aktgjyqimit të plotfuqishëm. Më 11.12.2008 aktgjykimi në fjalë nuk ishte i plotfuqishëm ashtu qe ekzekutimi ishte ende i zbatueshëm.

Në anën tjetër, gjykata duhet të këtë parasysh të gjitha zhvillimet procedurale të cilat kanë ndodhur deri në kohën kurë është bere lëshimi i aktgjyqimit. Me aktvendimin e plotfuqishëm instanca e dytë e revokoi aktvendimin e instancës së parë në rastin 420/05 ashtu qe procedura në pritje është kthyer se bashku me masat e përkohshme të siguruara.

Lidhur me këtë seanca e dytë e gjene rastin civil 420/05 dhe rastin e ekzekutimit 569/05 si të ndikuar nga procedura në rastin civil 805/07 të cilat nuk janë të relevante. Rasti 805/07 ishte çështje gjyqësore ndërmjet [REDACTED] dhe komunës së Prizrenit dhe rasti në fjalë ishte rreth pronësisë së ngastrës së njëjtë e cila është pjesë e padisë së pengim posedimit të parashtruar nga [REDACTED] Sidogoftë, as palët e as këshilla gjyqësore nuk kanë kërkuar qe në rastin 805/07 duhet në mënyrë ligjore të kenë ndikim në padinë e pengim posedimit të parashtruar nga [REDACTED] Veprimet ligjore lidhur me pronësinë dhe posedimin janë të tjera dhe nuk duhen të ngarrohen.

Duke marrur parasysh arsyet të lartcekura, gjykata e qarkut të Prizrenit e gjene aktvendimin e ankimuar si të pa bazuar dhe nëpërmjet kësaj e lejon ankesën.

GYKATA E QARKUT TË PRIZRENIT

Ac. nr. 22/2009 me 21.06.2010

Kryetari i trupit gjykues
Vladimir Kanev

KËSHILLA LIGJORE: kunder këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa